



## Marrëdhëniet mes myslimanëve dhe të krishterëve

### Description

#### Tarek Mitri

Ndërsa angazhohemi në një bashkëbisedim të sinqertë me të afërmit tanë të feve të tjera, ka raste që ne nuk shmangemi nga ushtrimi ose pohimi i të drejtës të të qenit i gabuar. Por ne mësojmë të jemi më të kujdesshëm me të drejtën e të qenit të thjeshtë ose ideologjik. Për të krishterët t'i afroresh fesë islame dhe realitetit të myslimanëve, nuk ka gjë më thjeshtëzuese në mënyrë të rrezikshme sesa imazhet sensacionale. Gjithashtu asgjë nuk është më ideologjike në mënyrë të gënjeshtërt sesa kulturizmi dhe esencjalizmi.

Miliona marrësve jokritikë të informacionit bota u paraqitet në formën e imazheve të qarta, ngjarjeve të shkurtra dhe citateve. Por imazhet dhe tekstet e koduara me pak informacion nga konteksti, mund të fshehin ose errësojnë, më tepër sesa të shpalosin, komplikimet e situatave të ndryshme dhe gjithmonë në ndryshim.

Perceptimi kulturalist kombinon relativizmin fetar dhe epërsinë e kulturës humaniste laike. Të krishterët mesjetarë e përcaktonin epërsinë e tyre sipas marrëdhënieve fetare. Aktualisht shumë nga homologët e tyre krenohen me përparësinë e tyre dhe me paraprirjen ndaj myslimanëve, gjatë rrjedhës së skepticizmit fetar dhe tendencës laiciste. Disa dekada më parë shumë njerëz, jo vetëm sociologët dhe filozofët e feve, kërkuan për një thelb të përbashkët për të gjitha fetë. Pa shumë vështirësi ata e kanë zhvlerësuar deklarin e krishterë për veçanti. Atëherë pati një interes të gjerë të ngjashmërive mes feve. Sot ekuilibri është në favor të atyre që shohin vetëm ndryshimet. Nuk është e pazakontë të shohim njerëz që nxitojnë të shpjegojnë dhunën terroriste, nga pikëpamja e asaj që ata e perceptojnë se është karakteristike e Islamit. Si rrjedhim ata nuk arrijnë ta kuptojnë se një dhunë e tillë nuk është e bazuar në vlerat tradicionale të Islamit. Por ndodh krejt e kundërta, kjo provokohet nga humbja e këtyre vlerave pa një kompensim real të ofruar nga modernizmi, shpesh i paplotësuar ose i imponuar.

*Shprehjet e esencjalizmit: i ashpër apo i hollë*

Esencjalizmi karakterizohet mjaft nga theksimi i veçantisë dhe ndërprerjes. Në shumë raste faktet sociologjike të myslimanëve, larmia e kushteve të tyre politike dhe kulturore shihen në thelb si të njëjta.

Për ata që janë të paaftë ose nuk janë të gatshëm ta njohin shumicën e tyre, krahasimet e fakteve kombëtare në botën myslimane kthehen në analogji dhe situatat specifike që nuk përputhen me modelin e paramenduar dallohen si përjashtime, që e konfirmojnë parimin. Esencializmi nuk kalohet i pavënëre. Ai mund të nxitet edhe në kohë lufte. Sapo identifikohet dhe ballafaqohet me dije kritike dhe përvoja të jetës, shprehjet e tij themelore e humbasin besueshmërinë e tij. Por esencializmi në format e tij të holla dhe me nivel, mbetet me ndikim të madh. Ai konfirmon paragjykimet dhe stereotipet e ashpra. E shumta ai mund t'i zbusë ato.

Në librin e tij të fundit orientalisti Bernard Luis, përpiket të identifikojë arsyet rrënjësore që fshihen pas rënies tragjike të Islamit nga madhështia intelektuale dhe kulturore që posedonte në Mesjetë. Duke u munduar t'i përgjigjet pyetjes “?farë nuk shkoi siç duhet?” ai shikon me ton therës aspektet e ndryshme të ndikimit perëndimor, nga ligji te muzika dhe reagimi osman. Kuptohet që ai i jep përparësi asaj që di më mirë. Por ai e përfundon kërkimin e tij historik e të mprehtë me një përgjithësim të vrazhdë. Në kapitullin e fundit ai e trajton Islamin si të ishte një realitet vigan. Myslimanët e një Lindjeje të Mesme të padallueshme mendojnë, thotë ai, se në njëfarë mënyre historia i ka tradhtuar ata. Ai sugjeron se pyetjen “?farë nuk shkoi si duhet?” ata e zëvendësuan me “Kush na e bëri këtë?”, duke çuar vetëm në “fantazi nevrastenike dhe teori komplotesh”. Ai shton se nëse popujt e Lindjes së Mesme vazhdojnë në rrugën aktuale “kamikazët do të bëhen një metaforë për të gjithë rajonin dhe nuk do të ketë shpëtim nga një rënie e mbushur me urrejtje dhe zemërim, tërbim dhe keqardhje ndaj vetvetes. Një mënyrë tjetër ideologjike periodike ilustruhet nga ata që argumentojnë se inferioriteti i të krishterëve nën drejtimin islamik, është një personifikim i një dhimma ose një marrëveshjeje trans-historike. Bat Ye’or, një autore shumë e përmendur izraelite, jep një shembull të përhershëm të të qënurit një i krishterë ose hebre i ndrydhur, nën Islamin. Sipas pikëpamjes së saj, ndryshimet e fundit kanë pak lidhje, sepse Islami ka rilindur në formën e islamizmit. Asnjë lëvizje kulturore ose politike nuk arriti një përmirësim të pakthyeshem të statusit të tyre si pakica inferiore. Në fakt ajo qorton të krishterët nga bota arabe, sepse kanë menduar se mund ta modernizonin Islamin dhe ta bashkërendonin atë me idenë e tyre të një kombi. Me një ton qortues ajo shton se ligjëratat patriotike e adoptuar nga këto të krishterë, është shprehja e një qasje të përvetësuar prej dhimiu.

Jo çuditërisht ajo kërkon burime historike që duket se vërtetojnë modelin e pandryshueshem të marrëdhënieve shumicë-pakicë në botën islame. Si pasojë ajo sugjeron që të krishterët të ndjekin vetëm “alternativën izraelite”. Duke i fajësuar se nuk kanë guxuar t'i imitojnë hebrejtë, shqetësimi i saj për fatin e tyre do të thotë të sjellësh prova për një intolerancë themelore të Islamit. Për të qenë të sigurt, krahasimi i saj mes të krishterëve dhe hebrejtë “sipas Islamit” është një mjet shfajësues shtesë, por jo shumë i zakonshëm, për ta përshkruar sionizmin si një projekt çlirimi për hebrejtë e shtypur, jo vetëm në Evropë, por edhe në botën islame. Shtrembërimi i saj anakronik duket se nuk e shqetëson atë.

### *Faktet historike: kompleksiteti dhe shumica*

Është e tepërt të themi se përdorimi i një çelësi shpjegues nuk na e bën të mundur ta kuptojmë kompleksitetin e marrëdhënieve të gjera mes të krishterëve dhe myslimanëve përgjatë historisë. Ata kanë njohur rivalitetin dhe luftën në shkallë globale. Ndjenja e përbuzjes dhe epërsisë ishte e fortë nga të dyja palët, por madje dhe në kohë përbaljeje ushtarake si gjatë kryqëzatave, ato ngacmoheshin nga ndjenjat e dyshimit, kuriozitetit madje dhe të admirimit. Shpesh harrohet se ka pasur disa përplasje të pasura dhe pjellore në fushat e jetës dhe mendimeve. Një nga tiparet e memories sonë historike, sado për të ardhur keq që mund të jetë, ka qenë mënyra me të cilën konfliktet errësojnë ngjarjet paqësore

dhe qortimet shuajnë zërat e mirëkuptimit. Në kohët e tensioneve dhe konflikteve një numër i konsiderueshëm të krishterësh tregojnë se kanë trashëguar në mënyre pasive disa paragjykime, kryesisht në fushën fetare.

Përvojat tradicionale ishin të vetëmjaftueshme. Qëndrimet ekskluziviste dhe reduksioniste drejt feve të tjera po mbizotëronin. Gjoni i Damaskut dhe shumë nga pasuesit e tij shihnin në Islam një herezi hebreo-kristiane. Dijetarët fetarë myslimanë konfirmojnë se Këshilli i Nikesë kishte prishur Ungjillin dhe e kishin bërë Jezusin Zot. Për këtë arsye vetëm shpallja kuranore tregon të vërtetën për krishterimin. Para ngritjes së Islamit, Krishterimi kishte krijuar kategori për fetarët e tjerë: hebrenj, paganë dhe heretikë. Kur të krishterët u përballën me myslimanët, ata e kuptuan veçantinë e tyre fetare sipas këtyre kategorive. Ata nuk i përdorën fjalët e myslimanëve dhe Islamit. Por ata përdorën terma etnike si arabët, ose biblike si Islamilitë, Hagareanë dhe Saraçenë – a nuk e largoi Sarah Hagar-in bosh? Pushtuesit myslimanë ishin ndëshkim të dërguar nga Zoti për t'i dënuar të krishterët për mëkatet e tyre. Por ky nuk ishte fitim i vogël të shpëtohej nga shtypja perandorake romake, shkruan kronisti i krishterë sirian i shekullit të IX Dionysus Tel Mahre. Armeni Sebeos kishte shkruar që në vitin 661 e.s., se Zoti u dha arabëve tokat që i kishte premtuar Abrahamit dhe u dha fitoren kundër bizantinëve jobesimtarë. Edhe në shekullin e XVII dimë vetëm një figurë të pasqyruar në pikëpamjet e Sebeos. Anastasios, një murg i manastirit Shën Katerina në Sinai, e sheh pushtimin arab si një dënim për monofizismen e Herakliut.

Uniteti dhe fuqia muslimane përkuan me dobësinë bizantine. Pushtimet e shpejta të myslimanëve, konfirmuan besimin se Zoti ishte në anën e tyre. Ky kuptim i vetësigurt i misionit hyjnor ishte sigurisht faktori kryesor për suksesin dhe shpejtësinë e pushtimeve pasuese. Ata nuk luftuan kundër të krishterëve dhe as nuk i detyruan të ndërrojnë fenë, por u siguruan atyre lirinë për të praktikuar fenë e tyre dhe u ofruan mbrojtje nën mbikëqyrje.

Marrëveshjet e ndryshme dhima pasqyruan këtë nocion me forma dhe shkallë të ndryshueshme të vartësisë së krishterë. Parimi udhëzues i marrëveshjes dhima shpalli:

“atyre u përkasin të gjitha ato që na përkasin ne dhe për ta është e detyrueshme gjithçka që është e detyrueshme për ne”. Një bindje politike, që përfshin një formë të caktuar nënshtrimi, u konkretizua me pagesën e një takse lokale, xhizjen.

Historia e hershme islame, veçanërisht gjatë fazës formuese të qytetërimit arabo-islam, është dëshmitare e mundësisë së fitimit dhe si pasojë e integritetit të kontributit, që të krishterët ishin të aftë dhe të gatshëm për ta ofruar. Ata patën gjithashtu mundësinë për të ndikuar në vetëvendosjen e komunitetit dominues. Ata ishin ndihmës nëpërmjet transmetimit, por edhe krijimit, në fusha të ndryshme të dijes njerëzore, në ndërtimin e një rendi jo të krishterë të racionalizuar me ndjenjë fetare. Ata parashtruan shumë nga pyetjet kritike dhe siguruan një pjesë të materialit dhe metodës me anë të të cilave myslimanët mund t'i hartonin përgjigjet e tyre. Por kur puna mbarohej ata mënjanoheshin.

Edhe pse akoma një shumicë në shumë pjesë të perandorisë muslimane, të krishterët u mbyllën në vetvete. Nxitja krijuese dhe arritja kulturore u kufizuan kryesisht tek ruajtja. Përveç kësaj kishte kohë ku dyshimi dhe presioni ndaj të krishterëve e përshpejtuan procesin e kalimit mënjane. Komunitetet e krishtera, ose fraksionet e tyre, u identifikuan ose mendohej se u identifikuan, me armiqtë e jashtëm të umetit mysliman. Mosbesimi çoi në zhvillimin dhe zbatimin e një kodi më të ashpër të drejtave dhe detyrimeve të dhimmi-ut. Është e vërtetë se inferioriteti ligjor dhe ndryshimet rastësore në besnikëritë politike shkaktuan një erozion të energjive të të krishterëve, por mbijetesa e tyre u siguroa nga

toleranca. Ata ishin akoma të aftë të ishin partnerë në dialog, jo vetëm në mënyrën apologjetike. Pavarësisht nga kufizimet e shumta të vëna tek ndërveprimi social dhe marrëdhëniet qytetare të drejta, ishte i mundur bashkëveprimi dhe shkëmbimi. Përplasje reale ndodhën mes personave. Në nivelin popullor mënyrat e jetesës dhe ndjenjat ndaheshin me një sens përsosmërie pothuajse identik, besim në Providencën Hyjnore dhe nënshtrim ndaj vullnetit të Zotit. Mes intelektualëve, pati një dialog të hapur, paralel me apologjetikën, i ndërmjetësuar përmes filozofisë. Shumë figura shpirtërore nuk ishin të imunizuara ndaj ndikimit të tjetrës. Të krishterët nuk ishin të pandjeshëm ndaj asaj që thuhej për Jezusin, "Jezusin musliman". "Vula e Shenjtërisë" ashtu si e quan Ibn Arabi, Jezusi u nderua më tepër nga mistikët myslimanë.

Shqetësimi për vetëruajtjen dhe mbijetesën përcaktuan një realitet të kufizuar. Marrëveshja dhimma arriti formën e vet më të zhvilluar të kodifikimit në sistemin e mileteve nën perandorinë osmane. Miletet nuk ishin kombe, siç sugjerohej zakonisht dhe perandoria një lloj bashkimi shumëkombësh. Ata ishin komunitete fetare shumëkulturore dhe shumëgjuhësore. Fjala millet vjen nga fjala arabe kuranore milla, që do të thotë besim ose rrugë fetare. Sistemi i milletit zbatoi parimin e dhimmas të marrëdhënies kontraktore.

Komunitetet fetare kishin institucionet e tyre juridike dhe administrative, sipas autoritetit të hierarkive të kishave. Pushteti qendror islam ushtronte një kontroll të përgjithshëm, por nuk ndërhynte në funksionimin e brendshëm të mileteve. Shumë shpejt u bë e qartë se miletet joterritoriale nuk ishin të imunizuara nga ndërhyrja e huaj. Mbështetja evropiane për komunitete të ndryshme të krishtera ndryshoi gradualisht ekuilibrin e pushtetit brenda Perandorisë Osmane. Projektet e ripërtëritjes dhe emancipimit kombëtar po funksiononin mes të krishterëve. Në të njëjtën kohë, interesat e tyre ishin një alibi për ndërhyrjet e të jashtëmeve. Komponenti kulturor i shumicës fetare u prek mjaft. Përhapja e arsimit perëndimor nëpërmjet shkollave misionare nënvizoi ndryshimet mes komuniteteve. Të krishterët shkuan drejt një lloji të ri kulture, ndaj të cilës muslimanët kishin një hyrje të kufizuar. Ky akulturim u dha të krishterëve, deri atëherë të dobët një mënyrë të re të vetëafirmimit. Për ta ndikimi perëndimor ishte shpesh një burim i mirëqënies ekonomike dhe formave të holla të fuqisë politike. Si rrjedhim u ndryshuan marrëdhëniet shumicë-pakicë. Mundësi të reja politike i lejuan disa komunitete të krishtera, ose fraksionet e komuniteteve të lëvizin më shpejt, disa do të thonin menjëherë, nga pranimi i sistemit të milletit, tek një strategji militante nacionaliste dhe separatiste. Kjo hedh dritë në masakrat tragjike pasuese dhe dëbimet e armenëve, asirianëve, grekëve dhe të tjerëve.

### *Pakti bashkëkohor i qytetarisë.*

Këtu ishin të krishterët që kundërshtonin, ndonjëherë me ngulm, tendencat separatiste të anëtarëve të tyre të fesë. Disa zgjodhën ideologjitë moderne dhe universaliste.

Ata u mundësuan atyre të lëviznin identitetin e pakicës, që mendonin se ishte regresiv dhe përçarës. Ata e theksuan identitetin e tyre të përbashkët etnokulturor me muslimanët, si baza e pavarësisë dhe e ndërtimit të kombit modern. Lidhja patriotike forcoi kundërshtimin ndaj pushtetit osman qendror dhe shtypës dhe më vonë të fuqive dominuese evropiane. Si rrjedhim në luftën për pavarësi dhe në arritjen e saj u shpall marrëveshja e qytetarisë, duke zëvendësuar marrëveshjen e mëparshme dhimë. Në rastin e Palestinës, marrëveshja e qytetarisë u konfirmua, ndërsa të krishterët dhe muslimanët vuanin bashkë shpronësimin dhe dëbimin dhe ndërsa rezistojnë sot kundër pushtimit, në rrugën e tyre të gjatë dhe të dhimbshme drejt pavarësisë.

Është e vërtetë që në botën arabe e më tej qëndrimet milletiste nuk u zhdukën. Në kërkim të

pavarësisë dhe çlirimit u rrit vetëdija islamike. Një autoritet u shfaq dhe fitoi vëmendje kundër dështimit të qeverive moderne, pak a shumë laike të pavarura dhe autoritare. Në disa raste kjo ka çuar në ndjenja antikristiane. Thuhet dhe besohet se fuqitë koloniale dhe më vonë qeveritë kombëtare, favorizonin të krishterët dhe i përdornin për të fituar dominimin e tyre. Pavarësisht sesa të diskutueshme janë këto perceptime, sot do të ketë gjithmonë njerëz si dje, të cilët nuk mund ose nuk guxojnë t'i kundërshtojnë ata që i zemërojnë ato. Pa vetëdije kërkojnë zëvendësues dhe shpesh i gjejnë ato.

### *Globalizimi i marrëdhënieve mes myslimanëve dhe të krishterëve*

Vitet e fundit është bërë e vështirë heqja dorë nga efektet në formë jehone në disa pjesë të botës, të një bisede për përballjen globale mes krishterimit ose perëndimit dhe Islamit, edhe pse bota perëndimore bashkëkohore është vetëpërcaktuar kryesisht si laike dhe myslimanët gradualisht e perceptuan atë të tillë. Të krishterët joperëndimorë mund të identifikohen nga ana kulturore dhe ndonjëherë politikisht me perëndimin, pavarësisht nga konfirmimi i tyre i shpeshtë i dallimit fetar dhe kulturor.

Në botën myslimane modelet e mendimit ideologjik e paraqesin perëndimin si egoist, materialist dhe dominues. Në perëndim modelet ekuivalente të mendimit e perceptojnë Islamin si irracional, fanatik dhe ekspansionist. Në epokën e komunikimit dhe të migrimit global, këto modele mendimi, në variacionin e tyre të shprehjeve të holla dhe jo të holla, ushqejnë antagonizmin. Është e vërtetë se çështja e Islamit dhe perëndimit është më komplekse dhe e paparashikuar në problemet bashkëkohore, sesa do të nënkuptonin ithtarët dhe kundërshtarët e politikës kulturaliste. Shumë nga problemet, si ndërhyrja dhe hegjemonia e huaj, terrorizmi dhe kërcënimet ndërkombëtare, janë të ngatërruara dhe të zmadhuara. Faktikisht ato përcaktohen nga politika e forcës së shteteve dhe forcave brenda kombeve të ndryshme. Por mbetet i vërtetë fakti se fundi i ballafaqimeve ideologjike mbarëbotërore ka favorizuar rishfaqjen e perceptimeve, ku Islami dhe perëndimi ekzistojnë si koncepte imagjinare e subjektive, të cilat ndikojnë në mënyrën se si secila e konsideron tjetrën.

Përveç rreziqeve dhe qëndrimeve të gatshme për luftë që nxiten nga tendenca për të globalizuar marrëdhëniet mes myslimanëve dhe të krishterëve, mund t'i referohemi mënyrës më të cilën mbrohen nga perëndimi të drejtat e pakicave të krishtera kryesisht në shtetet islamike. Logjika e reciprocitetit e huazuar nga shtetet, nga komunitetet fetare, favorizon një pikëpamje botërore duke kundërshtuar një umet (umma) islam me botën e krishterë, pavarësisht nëse nuk janë të dyja realitete historike aktualisht, secila duke pasur një degëzim për "vendbanimin" e tjetrës. Të ndryshme asimetrikisht, pakicat perceptohen ndonjëherë si viktimë dhe jo si aktorë. Aftësia e tyre për të vepruar si pajtues është në rrezik të madh, kur ata detyrohen të kalojnë në gjendjen e pengjeve. Një rol i tillë ndërmjetësimi, që shumë prej tyre vazhdojnë ta bëjnë, vihet në rrezik kur shkeljet e të drejtave të njeriut adresohen në mënyrë përzgjedhëse. Shumë nga interesat e pakicave të krishtera nuk mund të mbrohen dhe përkrahen përveç se në lidhje më ato të shumicave myslimane mes të cilave ata jetojnë.

Duke përkrahur të drejtat e të krishterëve në botën myslimane, në një mënyrë që konfirmon dyshimin se mbrojtja e pakicave u shërben qëllimeve të ndërhyrjes së huaj, përforcohet perceptimi se ata janë të huaj në vendet e tyre ose jo besnike ndaj tyre. Duke mbrojtur të drejtat e të krishterëve në kundërshtim me bashkëqytetarët dhe fqinjët e tyre myslimanë, me të cilët ata ndajnë kulturën dhe identitetin kombëtar, ashpërsohet dyshimi i shumicave drejt pakicave, që shihen si një mjet i një kërcënimi real dhe potencial i nxitur nga forcat e huaja dhe të fuqishme.

### *Konfirmimi i qytetarisë dhe tensioneve de-globalizuese*

Parimet universale të bashkëqytetarisë, barazisë, forcës së ligjit dhe të të drejtave njerëzore duhet të jenë në qendër të “dialogut të jetës” mes të krishterëve dhe myslimanëve. Universaliteti i tyre konfirmohet shpesh, duke mos përballuar ndryshimet në qëndrime dhe rëndësi. Nevoja e bashkëpunimit mes të krishterëve dhe myslimanëve në përkrahjen e këtyre vlerave në çdo rajon të botës është më e madhe. Këto çështje duhet të adresohen, teorikisht dhe praktikisht, me forcë të përtërirë dhe në të gjithë botën.

Bashkëqytetaria është ballafaqimi i personave si aktorë të barabartë në shoqëri dhe shtet të cilët ndërsa janë të ndikuar nga kultura, feja dhe etnia, nuk mund të ulen në rolet e caktuara për ta në emër të identiteteve të përbashkëta, besnikërive dhe interesave të perceptuar.

Shumë të krishterë dhe myslimanë janë bërë shumë të vetëdijshëm se të drejtat njerëzore nuk duhet të plotësohen me seleksionim. Për ata që besojnë, është vendimtare që të këmbëngulin në pandashmërinë e të drejtave njerëzore, të koordinojnë të drejtat individuale me ato të komunitetit dhe t’u gjenden pranë të dëmtuarve, pavarësisht nga identiteti i tyre fetar ose etnik. Mbrojtja e të drejtave njerëzore nuk duhet të kushtëzohet nga solidariteti rrëfyesor, pavarësisht sa legjitim është ai. Kjo duhet të jetë po aq e vërtetë edhe për përkrahjen dhe respektimin e ligjshmërisë ndërkombëtare. Universaliteti i normave politike dhe etike që mbështesin ligjin ndërkombëtar njihet përgjatë ndarjes fetare dhe fton për qëndrueshmëri. Por nuk është kjo çështja. Një shembull goditës është ligjërimi i përdorimit të forcës kundër një shteti që nuk vepron në përputhje me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ndërsa një shtet tjetër në të njëjtin rajon privilegjohet duke mos u ndëshkuar, ndërsa nuk merr parasysh sistematikisht rezolutat e të njëjtit këshill (që nga viti 1967 ka 32 të tillë).

Më shumë se asnjëherë më parë të krishterëve dhe myslimanëve u bëhet thirrje të mbrojnë një sërë vlerash universale të përbashkëta që i afrojnë më shumë me njëri-tjetrin. Në emër të këtyre vlerave atyre u kërkohet të bashkojnë përpjekjet në kontekstin e konflikteve dhe tensioneve të përbashkëta, që në mënyrë të zmadhuar identifikohen me ndryshim fetar. Disa pasqyrime të kësaj përgjegjësie propozohen nga një dokument studimi i hartuar nga një grup myslimanësh dhe të krishterësh partnerë në dialog dhe i botuar nga Këshilli Botëror i Kishave. Për të qenë të sigurt, Krishterimi dhe Islami edhe pse në mënyra të ndryshme që janë specifike për rajone të veçanta, mbartin kujtime të thella historike. Ata bëjnë thirrje edhe pse në mënyrë të paqëndrueshme, për besnikëri universale. Por ata shihen si shkaku i konfliktit, ndërsa shpesh nuk janë më shumë se një tipar rritës i debateve, shkaqet e të cilave janë jashtë fesë. Ka raste kur një konflikt në një vend, me shkaqet dhe karakterin e tij, perceptohet dhe përdoret si pjesë e një konflikti në një vend tjetër, me karakterin dhe shkaqet e tij të veçanta. Pra armiqësitë në një pjesë të botës përhapen në situata tensioni në rajone të tjera. Një akt dhune në një vend përdoret për të konfirmuar stereotipat e “armikut” në një vend tjetër ose edhe për të provokuar sulme hakmarrjeje diku tjetër në botë. Pra ai që është një konflikt i largët bëhet një problem lokal. Fqinjët bëjnë njëri-tjetrin fajtorë për të këqijat që u ngarkohen bashkëfetarëve të tyre gjetiu. Nëse ata

nuk janë të përgatitur për t'u ndarë publikisht nga ata me të cilët ndajnë të njëjtin besim, ata akuzohen për bashkëpunim me ta.

Prandaj është e rëndësishme të ofrojmë një perspektivë që kundërvepron ndaj proceseve që priren të përgjithësojnë konfliktet. Vëmendja ndaj shkaqeve të veçanta lokale ndihmon në gjetjen e zgjidhjeve. Kjo nuk është e mundur nëse drejtuesit e dy komuniteteve refuzojnë të tërhiqen në konfliktet e njëri-tjetrit në bazë të përgjigjes jokritike për thirrjet për solidaritet mes përkrahësve të një besimi. Në konfirmimin e parimeve të përbashkëta të besimit, drejtësisë dhe pajtimit, palët e konflikteve lokale ndihmohen që ta lirojnë Islamin dhe Krishterimin nga përgjegjësia e interpretimeve egoiste dhe interesave lokalë. Atëherë bindjet e krishtera dhe islame mund të përbëjnë bazën e angazhimit kritik me dobësitë njerëzore dhe rendin e mangët social dhe ekonomik. Pra myslimanët dhe të krishterët mësojnë se Krishterimi dhe Islami nuk janë dy blloqe të pandashme që i kundërvihen njëri-tjetrit. Në dialog me njëri-tjetrin "ata kuptojnë drejtësinë si një vlerë universale të ngulitur fort në besimin e tyre dhe u bëhet thirrje të mbajnë anën e të shtypurve dhe të atyre që janë lënë mënjanë, pavarësisht nga identiteti i tyre fetar. Drejtësia është një shprehje e angazhimit fetar dhe shkon përtej kufijve të komunitetit fetar. Myslmanët dhe të krishterët përkrahin vlerat dhe idealet e tyre fetare kur mbajnë një qëndrim të përbashkët në solidaritet me, ose në mbrojtje të viktimave të shtypjes dhe dëbimit".

Përktheu: Klodiana Malushaj

**Date Created**

16/10/2014

**Author**

erasmusi